



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0545

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE AS Tech SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat të Administratës Komunale, DKA-së dhe Q.K.M.F-së në Komunën e Dragashit me numër të prokurimit 621-24-4318-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes Dragashi, më 01.08.2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e AS Tech SH.P.K. me nr. 2024/0545, e datës 24.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat të Administratës Komunale, DKA-së dhe Q.K.M.F-së në Komunën e Dragashit me numër të prokurimit 621-24-4318-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes Dragashi.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunes Dragashi, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankesues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.05.2024 Kuvendi i Komunes Dragash., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat të Administratës Komunale, DKA-së dhe Q.K.M.F-së në Komunën e Dragashit me numër të prokurimit 621-24-4318-1-2-1.

Ndërsa me datën 04.06.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE Infinitt" SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizimë, vlera e parashkuar e kontratës: 15,950.00 euro.

Me 10.06.2024, OE AS Tech SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 14.06.2024.

Me 24.06.2024, OE AS Tech SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2024/0545, duke e atakuar Njoftimin mbi Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat të Administratës Komunale, DKA-së dhe Q.K.M.F-së në Komunën e Dragashit me numër të prokurimit 621-24-4318-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AS Tech SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i Operatorit Ekonomik (OE) në këtë rast është se Autoriteti Kontraktues (AK) ka shpërblyar me kontratë një ofertë të papërgjegjshme nga OE i rekomanduar, OE Infnit. OE pretendon se oferta e Infnit nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit dhe kjo sipas OE ankues është e dukshme në specifikat e produkteve të ofruara, të cilat kanë devijime të qarta nga kriteret e përcaktuara nga AK në dosjen e tenderit.

Në veçanti, OE ankues pretendon disa devijime në specifikat teknike si më poshtë:

Zhurma e presionit të tingullit (dB/A) për Outdoor Unit është 53 dB/A, ndërsa AK kishte kërkuar një nivel tjetër

- OE nuk ka dorëzuar specifikat e kërkuara nga AK, duke treguar se nivelit të zhurmës së produktit të ofruar është i ndryshëm nga ai që ka kërkuar AK në dosjen e tenderit.
- OE gjithashtu përmend një rast të mëparshëm të një ankesëje të trajtuar nga OSHP, ku paneli shqyrtues ka vendosur se nuk lejohet devijimi në rastet kur AK ka përcaktuar kufizimet e kapaciteteve. Ky precedent sipas OE-së është i aplikueshëm edhe në këtë rast për mos përmbushjen e specifikimeve teknike nga oferta e Infnit.

Për këto arsye, OE konkludon se oferta e Infnit është e papërgjegjshme dhe kërkon një trajtim të njëjtë nga OSHP siç është bërë në vendimin 584-2023, me qëllim që lënda të kthehet në rivlerësim dhe që AK të jetë i detyruar të shpërblejë ofertën e tyre në mënyrë të drejtë dhe ligjore.

Duke u referuar kërkesave si më sipër AS Tech SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 6, 7 dhe 28 LPP-së.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Kërkesa OE ankues për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e Prokurimit Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat të Administratës Komunale, DKA-së dhe Q.K.M.F-së në Komunën e Dragashit me numër të prokurimit 621-24-4318-1-2-1 është vlerësuar dhe konstatohet se është e pa bazë.

Pretendimi OE ankues se AK ka shpërblyar një OE të cilin nuk i ka përmbushur specifikimet teknike sipas njoftimit për kontratë nuk është i saktë. Komisioni për vlerësim, duke i shqyrtuar specifikat e kerkuara dhe ato të ofruara nga OE, ka konstatuar se disa OE kanë devijime të vogla. OE i shpërblyer me kontratë për pozicionin - nivelin e zhurmës nga min. 35 dB/A - max. 50 dB/A, ka ofruar 53 dB/A, që sipas vlerësimit tonë është një devijim i vogël. Po ashtu, edhe OE ankues si Operator Ekonomik që keni kërkuar rishqyrtim në lidhje me kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues për klasën e energjisë, vërehet se keni ofruar klima të cilat janë me klasë 1 A+ dhe jo siç ishte kërkuar në dosjen për kontratë A++ dhe A+++.

Për këto arsye, ne kemi vlerësuar se këto devijime të vogla në ofertë janë të pranueshme dhe në fund kemi shpërblyar OE-në me çmimin më të ulët. Bazuar në argumentet e paraqitura, vlerësojmë se pretendimi OE ankues në lidhje me vendimin e Autoritetit Kontraktues për rishqyrtim të vendimit nuk është i mbështetur në asnjë bazë.

Prandaj, vendimi është që kërkesa OE ankues AS Tech SH.P.K., për rishqyrtim të hedhet posht si e pa bazuar.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 08.07.2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të aprovohet si e pa bazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AS Tech SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0545 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, pavarësisht faktit se OE ankues është thirrur në vendimin paraprak të OSHP-së, vlerëson se Autoriteti Kontraktues (AK), në bazë të paragrafit 4 të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ka trajtuar ofertën si të mirëqenë. Neni 59, pika 4 thekson se "AK do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse një tender është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit."

Eksperti shqyrtues konstaton se pavarësisht nga kjo, Autoriteti Kontraktues mund të konsiderojë një tender të përgjegjshëm edhe nëse tenderi përmban devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat dhe kushtet e parashtruara në dosjen e tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas analizës së provovave të paraqitura nga palët dhe raportit të ekspertit shqyrtues ra në konkludim se procedura e prokurimit e publikuar nga Autoriteti Kontraktues. Kuvendi i Komunës së Dragashit, është zhvilluar në përputhje me LPP-në. Njoftimi për kontratë është bërë në mënyrë të rregullt më datën 02.05.2024, ndërsa vendimi për të shpërbluar kontratën me OE Infinit SH.P.K. për furnizimin dhe montimin e klimave është bërë me datën 04.06.2024, me një vlerë parashikuar prej 15,950.00 eurove.

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "OE AS Tech SH.P.K." dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "OE AS Tech SH.P.K." janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tëmbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunes Dragashi lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat të Administratës Komunale, DKA-së dhe Q.K.M.F-së në Komunën e Dragashit me numër të prokurimit 621-24-4318-1-2-1.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së

shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamenti Administratë nëafat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**
- **OE - AS Tech SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: